

UDHËZIM
Nr.13 datë 18.10.1993

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT "PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE
ISH-PRONARËVE" DHE DISA NDRYSHIME NË UDHËZMIN E KËSHILLIT
TË MINISTRAVE NR.3 DATË 21.6.1993**

Në mbështetje të ligjit nr.7698. datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", ndryshuar me ligjin nr.7736, datë 21.7.1993, për t'i dhënë zgjidhje disa problemeve që kanë dalë nga zbatimi i këtij ligji, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

1. Për efekt të nenit 3 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", kthehet ose kompensohet:

a) toka, e cila në momentin e shpronësimit ka qënë e regjistruar si truall dhe ndodhej brenda vijave kufizuese të qendrave të banuara:

b) toka, e cila në momentin e shpronësimit ka qënë e regjistruar si tokë bujqësore dhe ndodhej jashtë vijave kufizuese të qendrave të banuara por që në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit është kthyer në truall dhe ndodhet brenda vijave kufizuese të qendrave të banuara.

2. Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 21.6.1993, në pikën, shkronja "c" pas paragrafit me përmbajtjen:

"Kur është dhënë leje ndërtimi për një objekt të çdo lloji, por nuk ka filluar ndërtimi i tij, trualli quhet i lirë", shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: - Bëjnë përjashtim trojet e dhëna për investitorët e huaj , për të cilët është miratuar sheshi i ndërtimit sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi dhe me të cilët janë lidhur kontratat nga institucionet përkatëse para hyrjes në fuqi të ligjit, pavarësisht nga marrja e lejes së ndërtimit ose nga faza e punimeve të ndërtimit. Në këtë rast ish-pronarët e truallit kompensohen në mënyrat e parashikuara në ligj."

3. Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 21.6.1993, në pikën 10, shkronja "b", pas paragrafit të dytë shtohen dy pargrafe me këtë përmbajtje : "- E drejta e parablerjes për objektet e ndërtuara mbi truallin e ish-pronarit i njihet vetëm pronarit, titulli i të cilit ndodhej brenda vijave kufizuese në kohën e shpronësimit. Kjo drejtë e parablerjes vlen për objekte të ndërtuara në një sipërfaqe trualli deri 0,5 ha, por jo më shumë se 1 ha, e drejta e parablerjes vendoset nga Bordi i degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rreth.

Kur mbi një objekt që shitet vërtetohet se ka disa pronësi mbi truallin, atëherë të gjithë ish-pronarët e truallit kanë të drejtën e parablerjes në përpjestim në përqindjen e pronësisë së secilit mbi truallin. Mosmarrëveshjet në këto raste zgjidhen nga Bordi i degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rreth".

4. Në rastin e kthimit të fabrikave, punishteve dhe objekteve të ngjashme me to, përfshihen dhe makineritë e pajisjet, të cilat vërtetohen me dokumente që kanë qënë pronë e ish-pronarit dhe që janë në gjendje fizike në momentin e daljes së ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Në rastet kur këto makineri e pajisje janë rikonstruktuar duke u shtuar vleftën fillestare, atëherë do të veprohet sipas nenit 13 të ligjit të mësipërm. Kështu, nëse vlera e ndryshimeve të bëra përbën deri në 20 për qind të vleftës fillestare të makinerisë a pajisjes, atëherë i kthehet ish-pronarit pa kundërshtpërblim. Në rast se kjo vleftë zë 20-50 për qind të vleftës së objektit, atëherë i kthehet ish-pronarit, i cili detyrohet të paguajë kundërvleftën mbi 20 për qind. Kur vlefta e makinerive dhe e pajisjeve, së bashku me të gjitha ndryshimet që i janë bërë objektit, kalon mbi 50 për qind të vleftës së gjithë objektit, atëherë objekti mbetet në bashkëpronësi. Vlerësimi i makinerive dhe i pajisjeve bëhet në bazë të:

a) Vleftës fillestare të dokumentuar në kontabilitet si për pronën e ish-pronarit, ashtu edhe

për shtesat e bëra nga shteti.

b) Normave të amortizimit në fuqi. Për makineritë e pajisjet që janë pronë e ish-pronarit, periudha e amortizimit llogaritet në vitin e konfiskimit, shtetëzimit ose shpronësimit të tyre. Për shtesat e bëra nga shteti kjo periudhë llogaritet deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit.

c) Gjendja faktike e makinerive dhe e pajisjeve.

ç) Indeksit të çmimeve sipas pikës 18, shkronja "c" e udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.3, datë 21.6.1993.

5. Tabela e udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.3, datë 21.6.1993 shfuqizohet dhe zëvendësohet në tabelën që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

6. Detyrimet e palëve në përputhje me nenin 17 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" për bashkëpronësinë e kufizuar që vepron për 2 vjet, fillojnë nga momenti i shpalljes së vendimit të komisionit të kthimit dhe të kompensimit e pronave në rreth ose bashki.

7. Në dokumentet që përbëjnë dosjen e objektit që kërkohet t'i kthehet ish-pronarit, dokumentit që vërteton shpronësimin, konfiskimin, shtetëzimin ose marrjen e pronës nga shteti në çdo formë tjetër, fillimisht kërkohet që të sigurohet nga ish-pronarët.

Në rast se këta të fundit nuk e disponojnë atë, komisionet e kthimit dhe të kompensimit të pronave, me kërkesën e të interesuarve, janë të detyruara t'u japin një kopje të dokumenteve që disponohen për këtë qëllim. Organet e pushtetit lokal, të drejtësisë, deget e rendit etj. janë të detyruara t'i dorëzojnë komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave të gjitha dokumentet e nevojshme që kërkohen zyrtarisht prej tyre, ose të bëjnë deklaram zyrtar në rast se nuk i disponojnë ato.

8. Deklarata personale për efekt të nenit 24 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" kërkohet në të gjitha rastet, me përjashtim të rasteve kur dokumentohet që prona është regjistruar para vitit 1939. Në këtë rast deklarata paraqitet vetëm për efekt të paragrafit të tretë të nenit 24m të ligjit të mësipërm.

9. Vendimet e komisionit të kthimit të pronave ish-pronarëve në rreth ose bashki u komunikohen të dy palëve, d.m.th. ish-pronarit që i kthehet ose kompensohet prona dhe personit juridik a fizik, marrëdhëniet e pronësisë të të cilit lidhen me këtë vendim.

10. Vendimet e komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve në rrethe ose bashki janë të detyrueshme për ekzekutimin nga organet shtetërore përkatëse (organet e pushtetit lokal dhe policia).

11. Tarifa për 2000 lekë, e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993 "Për masat për zbatimin e ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", pika 2, shkronja "a", paragrafi 4, zbatohet për çdo kërkesë, në të cilën mund të përfshihet një ose disa objekte që kërkon ish-pronari t'i kthehen ose kompensohen.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

pronarëve", pika 2, shkronja "a", paragrafi 4, zbatohet për çdo kërkesë, në të cilën mund të përfshihet një ose disa objekte që kërkon ish-pronari t'i kthehen ose t'i kompensohen.
Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

KURSI I KËMBIMIT NË VITE

Lekë për 1 USD

<u>Muajt</u>	<u>Përpara vitit 1990</u>	<u>Në vitin 1991</u>	<u>Në vitin 1992</u>	<u>Në vitin 1993</u>
Janar	8.00	18.00	62	105.25
Shkurt	8.00	19.00	85	106.58
Mars	8.00	23.00	95	106.93
Prill	8.00	24.00	92	105.48
Maj	8.00	23.00	102	103.61
Qershor	8.00	25.00	120	
Korrik	8.00	25.00		
Gusht	8.00	25.00		
Shtator	8.00	25.00		
Tetor	8.00	33.00		
Nëntor	8.00	40.00		
Dhjetor	8.00	55.00		